

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AUTO JAPAN" shpk TIRANE

Sot me daten 15.09.2005, ne Tirane, une shtetasja Agustela Ceko, e bija e Harallambit dhe e Poliksenit, e datelindjes 13 Shtator 1974, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, rruga Muhamed Gjolllesha, Pallati 51, Apartamentit 24

V E N D O S A :

Krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "AUTO JAPAN" shpk Tirane

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte

" Import-eksport, tregeti me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve japoneze"

Qendra e shoqerise eshte qyteti i Tiranes me seli ne rrugen e Kavajes, prane ish Uzines Enver. Me zgjerimin e veprimtarise shoqeria do te cele dege te saj edhe ne rrethe e qytete te tjere te vendit.

Kapitali i shoqerise perbehet prej shumes ne leke 100.000 (njqindmije leke) prone e ortakut te vetem themelues dhe e depozituar ne Raiffesien Bank, Tirane.

Afati i veprimtarise se shoqerise "AUTO JAPAN" shpk Tirane eshte deri 10 vjet.

Administrator i kesaj shoqerie eshte themeluesja e saj zonja Agustela Ceko..

THEMELUESJA

Agustela Ceko





STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AUTO JAPAN" shpk TIRANE

FORMIMI

Neni 1

Ne baze te aktit te themelimit te dates 15.09.2005, ne Tirane u krijua Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "AUTO JAPAN" shpk Tirane., me ortak te vetem Agustela Ceko, e bija e Harallambit dhe e Poliksenit, e datelindjes 13 Shtator 1974, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, rruga Muhamed Gjolllesha, Pallati 51 Aapartamenti 24.

Neni 2

Emri i shoqerise do te jete : "AUTO JAPAN" shpk Tirane., me karakter tregtar.

Neni 3

Qendra e shoqerise eshte qyteti i Tiranës, kurse selia ne rrugen e Kavajes, prane ish Uzines Enver. Me zgjerimin e veprimtarise se saj shoqeria do te cele dege edhe ne rrethe e qytete te tjere te vendit.

Neni 4

Shoqeria "AUTO JAPAN" shpk Tirane ka si objekt : Import-eksport, tregeti me shumice e pakice te pjeseve te kembimit te automjeteve japoneze.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Shoqeria "AUTO JAPAN" shpk Tirane do te ushtroje veprimtarise e saj per nje afat kohor deri ne 10 vjet.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i shoqerise eshte ne vleren prej leke 100.000 (njqindmije leke) te depozituar ne Raiffeisen Bank Tirane.

Ky kapital eshte prone individuale e ortakut te vetem themelues te saj zonjes Agustela Ceko.

Neni 7

Me rritjen e veprimtarise se shoqerise, kapitali i saj i themelimit mund te rritet si ne vlere ashtu dhe ne natyre. Ne kete rast zbatohen respektivisht kriteret e neneve 40 e 42 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 8

Kur cmohet e arsyeshme, shoqeria mund te vendose per zvogelimin e kapitalit te themelimit. Ne kete rast per procedure zbatohen kriteret e percaktuara nga neni 64 i ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Ne rast te shtimit te numurit te ortakeve, zvogelimi i pjeses se kapitalit te cdo ortaku do te behet ne raport me perqindjet e kapitalit qe ata zoterojne.

Neni 9

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te themelimit behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

Ne rast kur shoqeria perbehet nga me shume se nje ortak, vendimet jane te vlefshme kur ato merren nga ortakët qe perfaqesojne $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar

Ne rast kur shoqeria ka nje ortak te vetem, vendimet merren nga ortakut i vetem.

FORMA E PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Neni 10

Pjese te kapitalit nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Transferime te pjeseve te kapitalit duhet te behen me akt noterial. Shoqeria dhe te tretet duhet ti respektojne keto sapo tu behen te ditura.

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR NE RRUGE TRASHEGIMIE

Neni 11

Pjese te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, si dhe midis bashkeshorteve.

Ne rast te shtimit te numarit te ortakeve ne kete shoqeri, per transferimin ne rruge trashegimie ose midis bashkeshorteve, ortaket mund te procedojne sipas nenit 46 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

TRANSFERIMI TE TE TRETET

Neni 12

Pjese te kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri. Transferimi eshte i vlefshem kur behet me vendim te ortakeve qe zoterojne jo me pak se 3/4 e pjeseve te kapitalit te themelimit. Ne kete rast do te procedohet sipas nenit 47 te Ligjit nr.7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare".

ADMINISTRIMI

Neni 13

Oragenet drejtuese te shoqerise "AUTO JAPAN" shpk Tirane jane :

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Neni 14

Administratori i shoqerise "AUTO JAPAN" shpk Tirane eshte zonja Agustela Ceko.

Per sa kohe kjo shoqeri do te perbehet nga nje ortak i vetem, sikurse eshte krijuar, administratori i saj ka te gjitha kopetencat qe i jep neni 16 i ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Ne rast te shtimit te numarit te ortakeve, kopetencat do te caktohen ne marreveshje midis tyre.

Neni 15

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise e te treteve, per shkeljet e ligjit, statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Per nxjerjen e pergjegjesise se administratorit do te procedohet konforme neneve 53 deri 55 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Neni 16

Shkarkimi i administratorit te shoqerise behet nga Gjykata.

Ne rast te shtimit te numarit te ortakeve, shkarkimi i administratorit behet nga ortaket qe zoterojne jo me pak se 1/2 e kapitalit te themelimit.

Cdo klauzole e kunderte eshte e pavlefshme.

Neni 17

Veprimet e shoqerise mbylljen ne daten 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Ne fund te cdo periudhe ekspertet e caktuar nxjerrin bilancin kontabel te shoqerise ose rezultatin financiar te fitimit apo humbjet sipas rregullave financiare ne fuqi.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja e ortakeve.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behen brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes se vitit financiar, duke respektuar procedurat e percaktuara ne nenin 56 te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 18

Pas miratimit te llogarise vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit, zbritet vlera e akumulimit qe perfaqeson 5 % te fitimit te cdo viti financiar.

Diferenca tjeter e fitimit eshte prone e ortakut te vetem themelues te shoqerise.

Neni 19

Shoqeria "AUTO JAPAN" veprimtarine me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete statut. Ajo mund te prishet gjithashtu para ketij afati ne rast se ekzistojne kriteret e percaktuara ne ligj.

Shoqeria "AUTO JAPAN" shpk Tirane nuk pushon veprimtarine e saj me vdekjen e ortakut themelues.

Neni 20

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone likuidatorin, i cili i paraqet asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit e mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit asambleja vendos: Mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi rregullshmerine e veprimtarise se shoqerise, te likuiduesit e mbylljen e procesit te likuidimit.

Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se gjitha detyrimeve, kapitalet e mbetura dhe fitimi, ne se ekzistojne, mbeten prone e ortakut themelues.

Neni 21

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontrate zbatohen dispozitat e legjislacionit Shqiptar

Neni 22

Shoqeria "AUTO JAPAN" shpk Tirane. eshte person juridik privat i pavarur. Ajo ka te drejta dhe detyra per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne ligjin nr. 7632 date 04.11.1992 dhe ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 23

Marreveshjet e shoqerise me te tretet, me persona juridike e fizike, vendas apo te huaj, zgjidhen ne mirekuptim, ne te kunderten sipas legjislacionit Shqiptar

Neni 24

Shoqeria "AUTO JAPAN" shpk Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesi per te vepruar pas regjistrimit ne Gjykatën e Tiranës.

Ky statut u hartua ne kater kopje, ne origjinal ne gjuhen shqipe, te cilat kane te gjitha te njejten fuqi ligjore.

ORTAKU THEMELUES

Agustela Ceke

